

V E N D I M
Nr.36, datë 14.10.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtari
Veli Budo,	Anëtari
Zija Vuci,	Anëtari
Alfred Karamuço,	Anëtari
Franc Jakova,	Anëtari

me sekretare Drita Filto, në datën 7.10.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.41 Akti që i përket :

K Ë R K U E S : UKE TODAJ, kryetar i Këshillit të Rrethit Kukës.

PALE E INTERESUAR : SEKRETARIATI SHTETEROR I PUSHTETIT LOKAL, në mungesë.

O B J E K T I :

Deklarimi antikushtetues i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.525, datë 12.8.1996 për caktimin e Z. Fiqiri Gjeta të deleguar të Këshillit të Ministrave që do të kryejë funksionet e kryetarit të këshillit të rrethit Kukës.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.525, datë 12.8.1996, pika 2, ka vendosur të caktojë z. Fiqiri Gjeta, të deleguar të Këshillit të Ministrave që do të kryejë funksionet e kryetarit të këshillit të rrethit Kukës, me arsyetimin se “kryetari i këshillit të rrethit Kukës z. Ukë Todaj është liruar nga detyra qysh prej datës 1.5.1996 për shkak të kandidimit të tij për deputet në Kuvendin Popullor të Republikës së Shqipërisë”.

Vendimin e tij Këshilli i Ministrave e ka mbështetur në Ligjin nr.8138, datë 31.7.1996 “Për një plotësim në Ligjin nr.8068, datë 15.2.1996 “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, në të cilin thuhet : “Në rast se këshilli i rrethit nuk arrin të zgjedhë kryetarin e ri brenda afatit të caktuar, Këshilli i Ministrave cakton një të deleguar të tij për të kryer funksionet e kryetarit të këshillit të rrethit”.

Gjatë shqyrtimit të çështjes nga Gjykata mbi ankimin e kërkuesit Ukë Todaj, ka rezultuar se vërtetë ai është liruar nga detyra e kryetarit të këshillit të rrethit Kukës nga data 1.5.1996 për shkak të kandidimit të tij për deputet në Kuvendin Popullor në zgjedhjet e 26 majit 1996, në të cilat ai nuk u zgjodh, por me vendimin nr.12, datë 7.6.1996 të këshillit të rrethit Kukës z. Ukë Todaj është zgjedhur përsëri kryetar i këshillit të këtij rrethi. Ky vendim nuk është kundërshtuar si i paligjshëm nga prefekti (neni 6 i Ligjit nr.7608, datë 22.9.1992 “Për Prefekturat”).

Sa sipër provohet me vendimin nr.12, datë 7.6.1996 të këshillit të rrethit Kukës dhe protokollin e mbajtur me rastin e zgjedhjes.

Kompetenca e këshillit të rrethit për të zgjedhur kryetarin ndërmjet këshilltarëve të tij buron nga pika 1 e nenit 45 të Ligjit nr.7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”.

Në këto rrethana, Gjykata çmon se duke caktuar më datë 12.8.1996 një të deleguar për të kryer detyrën e kryetarit të këshillit të rrethit Kukës, në një kohë që qysh më datë 7.6.1996 këshilli i rrethit Kukës e kishte zgjedhur kryetarin e tij, Këshilli i Ministrave ka shkelur si pikën 1 të nenit 45 të Ligjit nr. 7572, datë 10.6.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, ashtu edhe parimin e pavarësisë së organeve të pushtetit lokal, të sanksionuar në nenin 3 të Ligjit kushtetues nr.7570, datë 3.6.1992 “Për disa shtesa në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE ,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 24 e vijuesa të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991”Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

V E N D O S I :

Shfuqizimin si antiligjor dhe antikushtetues të pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.525, datë 12.8.1996, për caktimin e z. Fiqiri Gjeta të deleguar të Këshillit të Ministrave që do të kryejë funksionet e kryetarit të këshillit të rrethit Kukës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

MENDIMI I PAKICES

Jam kundër vendimit të shumicës.

Gjykata Kushtetuese nuk duhej të merrte vendim për zgjidhjen në themel të çështjes por vetëm ta shpallte atë jashtë juridiksionit të saj.

Në bazë të nenit 7 paragrafi i fundit i Ligjit nr.7570, datë 3.6.1992 “Për disa shtesa në Ligjin nr.7491, datë 24.9.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, kryetari i këshillit të rrethit nuk është organ i pushtetit lokal por organ ekzekutiv. Në këto kushte largimi nga detyra e kryetarit të këshillit të rrethit (duke mos e cënuar në këto raste nga qenia e tij si anëtar i këshillit, i zgjedhur nga populli), nuk është cënim i ndonjë prej të drejtave themelore kushtetuese.

Meqënëse Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.525, datë 12.8.1996, si akt administrativ, atakohet nga kërkuesi me arsyetimin se i prek atij të drejta të ligjshme, por siç theksuam nuk janë të drejta themelore, shqyrtimi i këtij konflikti nuk ka se si të marrë natyrën e kontrollit kushtetues. Ai është konflikt administrativ e si i tillë, në bazë të neneve 324 e vijuesa të Kodit të Procedurës Civile, hyn në juridiksionin e gjykatave të zakonshme (seksioneve të gjykimeve administrative pranë gjykatave të rrethit).

A N E T A R I

A. Karamuço

U shpall sot, më datë 14.10.1996